



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0016

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D.Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE “KosovaMed Healthcare SH.P.K.”, kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime shëndetësore shtëpiake-paliative dhe shërbime sociale e rezidenciale për personat në nevojë në Komunen e Shtimës”- Kontratë kornizë për 24 muaj” me numër të prokurimit 617-24-12907-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Shtime, më 01/04/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e “KosovaMed Healthcare SH.P.K.”, me nr. 2025/0016 e datës 06/01/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime shëndetësore shtëpiake-paliative dhe shërbime sociale e rezidenciale për personat në nevojë në Komunen e Shtimës”- Kontratë kornizë për 24 muaj” me numër të prokurimit 617-24-12907-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Shtime, ndërsa AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas dispozitave ligjore të LPP-së.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 10.12.2024 Komuna Shtime në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Shërbime shëndetësore shtëpiake-paliative dhe shërbime sociale e rezidenciale për personat në nevojë në Komunen e Shtimës”- Kontratë kornizë për 24 muaj” me numër të prokurimit 617-24-12907-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 445,174.12 €.

Me 25.12.2024, OE “KosovaMed Healthcare SH.P.K.”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit për Kontratë. Me 26.12.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06.01.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “KosovaMed Healthcare SH.P.K.”, me nr. 2024/0016 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime shëndetësore shtëpiake-paliative dhe shërbime sociale e rezidenciale për personat në nevojë në Komunen e Shtimës”- Kontratë kornizë për 24 muaj” me numër të prokurimit 617-24-12907-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “KosovaMed Healthcare SH.P.K.”, janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i pare (I) : “Operatori KosovaMed Healthcare SH.P.K. pretendon se kërkesa e AK-së për licencat "në nivel nacional" është një favorizim i hapur për një OJQ specifike. Ankuesi e konsideron këtë kërkesë të panevojshme, të ekzagjeruar dhe të papërshtatshme për objektin e kontratës, duke qenë se kontrata ka fokus lokal në Komunën e Shtimes. Sipas tij, fraza "në nivel nacional" është problematike dhe diskriminuese, pasi nuk ka justifikim për një standard të tillë për shërbime që ofrohen vetëm në një komunë specifike. Kjo kufizon konkurrencën duke favorizuar një OJQ që tashmë ka këto certifikata dhe diskriminon operatorët ekonomikë të licencuar në nivel lokal, të cilët kanë kapacitetin për të përmbushur kërkesat e kontratës. Kërkesa e AK-së: AK në kërkesat e përshtatshmërisë profesionale në Fletën e të dhënave (FDT) ka kërkuar se që operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ose

Ministria e Drejtësisë (MD), dhe atë nga Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare për shërbimet e mëposhtme: 4.1: Licencë për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes së drejtpërdrejt sociale në shtëpi dhe asistencë materiale për persona të moshuar dhe me aftësi të kufizuara, në nivel nacional. 4.2: Licencë për ofrimin e shërbimeve sociale dhe kujdesit ditor për persona me aftësi të kufizuara, fëmijë dhe të rritur. 4.3: Licencë për ofrimin e shërbimit të kujdesit ditor ose gjysmë ditor në rehabilitim dhe integrim social për fëmijë me vështirësi në sjellje dhe në mësim nxënie).Për të tri këto licenca si dëshmi dokumentare AK ka kërkuar që ato të jenë të nivelit nacional.”

Pretendimi i dyte (II) : “Ankuesi pretendon se kërkesa e AK-së për Licencë për Ambulancë Stomatologjike, përveç licencës për shërbime specialistike të mjekësisë familjare, është jorelevante dhe e panevojshme për objektin e kontratës. Sipas ankuesit, kontrata ka fokus në shërbime shëndetësore shtëpiake-paliative dhe shërbime sociale, ndërsa shërbimet stomatologjike përbëjnë vetëm një element dytësor dhe jo thelbësor. Kjo kërkesë, sipas ankuesit, krijon kufizim të panevojshëm për operatorët ekonomikë dhe favorizon një operator specifik, duke diskriminuar operatorët që plotësojnë kriteret kryesore të kontratës. Për këtë arsye, ankuesi kërkon që kërkesa për Licencë për Ambulancë Stomatologjike të hiqet ose të rishikohet. Kërkesa e AK-së: Sipas Dosjes së Tenderit, AK ka përcaktuar që operatorët ekonomikë duhet të jenë të licencuar nga institucionet përkatëse dhe të ofrojnë dokumentacion për: Licencë për ofrimin e shërbimeve specialistike të mjekësisë familjare. Licencë për Ambulancë Stomatologjike.”

Pretendimi i trete (III) : “Ankuesi po ashtu pretendon se AK ka vendosur kriterë diskriminuesë dhe favorizuesë në aktivitetin e prokurimit, duke i përshtatur ato për një operator specifik, konkretisht një OJQ. Këto kriterë, sipas ankuesit, janë në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, i cili kërkon trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Gjithashtu, ankuesi thekson se DT nuk është përgatitur në përputhje me nenin 27 të LPP-së, i cili ndalon vendosjen e kriterëve që kufizojnë konkurrencën ose favorizojnë një operator specifik. Për më tepër, ankuesi pretendon se AK ka refuzuar në mënyrë të padrejtë kërkesën për rishqyrtim, duke mos dhënë një arsyetim të qartë dhe të bazuar në dispozita ligjore, siç kërkohet nga neni 108/A i LPP-së. Ankuesi kërkon që AK të korrigjojë këto kriterë përmes formularit standard B54, duke siguruar përputhshmëri me dispozitat ligjore dhe krijimin e një procesi të drejtë dhe transparent të prokurimit .”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “KosovaMed Healthcare SH.P.K.”, konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 1,7, 51, 52, 66, 108/A të LPP-së si dhe neni 17, 25, 97 i Rrpp-se si dhe Neni 9.12 të Udhezuesit për prokurim publik. Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që pas trajtimit të Ankesës tonë të nxjerr: Vendim - Të nxjerrë vendim meritues me të cilin të aprovojë Ankesën tonë të bazuar të paraqitur nga KosovaMed Healthcare SH.P.K - Ta detyrojë AK-Komuna Shtime që ta korrigjojë ose të anulojë Njoftimin për Kontratë. Mbetemi me shpresë se Ankesa jonë do të shqyrtohet pozitivisht.

Përgjigje e Autortitetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim: Ne si AK kemi analizuar dhe kemi kërkuar sqarime nga njësia kërkuese lidhur me pretendimet e juaja për kërkesat që ju

pretendoni që janë në kundërshtim me natyrën e kontratës dhe LPP . Njësia kërkuese në përgjigjen e saj e ka dhënë arsyetimin, se këto kërkesa nuk janë diskriminuese dhe janë të përputhje me natyrën e shërmimeve që kërkohen nga OE i cili do të shpërblehet me kontratë . Ne si AK, Drejtoria e Prokurimit jemi të obliguar që të respektojm kërkesat që vin nga njësitë kërkuese, pasi që ata janë profesionist të fushës dhe ne nuk guxojm që mos ti respektojmë ato, pasi që kemi të bëjm me shëndetin e njerzve. OE mund ta paraqes ankesë pran OSHP-së brenda 10 ditëve nga data e vendimit të lëshuar nga Autoritetit Kontraktues , dhe ne si AK do të respektojm çdo vendim të OSHP-së.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 13/01/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0016/2025, ndërsa me datë 17/01/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/0016 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, Autoriteti Kontraktues nuk është pajtuar rreth raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “KosovaMed Healthcare SH.P.K.”, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0016 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I) : “Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i ankuesit është i bazuar, pasi kërkesa e AK-së për licenca "në nivel nacional" është disproporcionale dhe nuk lidhet qartë me objektivin e kontratës, e cila ka fokus të kufizuar lokal në Komunën e Shtimes. Kjo kontratë përfshin kujdes shëndetësor shtëpiak dhe paliativ, si dhe shërbime sociale e rezidenciale, të cilat janë të kufizuara në një zonë të përcaktuar dhe nuk justifikojnë kërkesën për standarde kombëtare. Licencat lokale janë të mjaftueshme për të garantuar përmbushjen e qëllimeve të kontratës dhe për të siguruar cilësinë e shërbimeve të kërkuara. Sipas nenit 25.17 të Rregullores nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik,

kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës. Kërkesa për licenca kombëtare përjashton operatorët ekonomikë që janë të licencuar vetëm në nivel lokal, por që kanë kapacitetin për të përmbushur të gjitha kërkesat e kontratës. Kjo shkel parimin e trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminimit të përcaktuar në nenin 7 të LPP-së. Për më tepër, sipas nenit 9.12 të Udhëzuesit nr.001/2023 për Prokurimin Publik (UPP), kriteret duhet të garantojnë konkurrencë efektive dhe të mos krijojnë avantazhe për operatorët që tashmë zotërojnë licenca të panevojshme për qëllimin e kontratës. Kjo kërkesë favorizon operatorët që posedojnë licenca në nivel nacional dhe kufizon konkurrencën, duke përjashtuar në mënyrë të padrejtë operatorët e tjerë të kualifikuar. Nuk ka asnjë argument të dokumentuar nga AK që tregon se si licencat në nivel nacional lidhen me cilësinë ose përmbushjen më të mirë të objektivit të kontratës. Eksperti shqyrtues rekomandon që AK të rishikojë këtë kërkesë dhe të lejojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë me licenca lokale ose kombëtare, duke siguruar që kriteret të jenë proporcionale dhe të ndërlidhura qartë me nevojat e kontratës. Nëse AK e konsideron këtë kriter të domosdoshëm, ajo duhet të sigurojë një arsyetim të dokumentuar dhe të lidhur qartë me objektivin e kontratës.”

Konstatimi i dyte (II) : “Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i KosovaMed Healthcare SH.P.K. për kërkesën e Licencës për Ambulancë Stomatologjike është i bazuar dhe ngre çështje të rëndësishme për proporcionalitetin dhe relevancën e kriterëve të vendosura nga AK. Kjo kërkesë duket të jetë e panevojshme dhe jorelevante për objektivin e kontratës, e cila ka fokus në shërbime shëndetësore shtëpiake-paliative dhe shërbime sociale në Komunën e Shtimes. Shërbimet stomatologjike përbëjnë vetëm një element dytësor dhe jo thelbësor të kontratës, duke treguar se vendosja e kësaj licence si kriter përjashtues është e pabazuar dhe krijon kufizime të panevojshme për konkurrencën. Sipas nenit 17.17 të Rregullores 002/2024, dosja e tenderit duhet të përgatitet në atë mënyrë që nuk kufizon konkurrencën në mesin e OE, dhe nuk diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE. Në këtë rast, kërkesa për Licencë për Ambulancë Stomatologjike nuk përputhet me këto kërkesa, pasi nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me realizimin e objektivit të kontratës dhe nuk është e domosdoshme për ofrimin e shërbimeve të përfshira në kontratë. Për më tepër, kjo kërkesë shkel nenin 7 të LPP-së, i cili kërkon trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, dhe nenin 25.17 nr.002/2024, i cili përcakton se kriteret e kualifikimit duhet të jenë relevante dhe proporcionale. Vendosja e kësaj licence si kriter përjashtues krijon pengesë për operatorët ekonomikë që përmbushin pjesën kryesore të kërkesave të kontratës dhe që janë të aftë për të ofruar shërbimet e kërkuara. Kjo jo vetëm që kufizon pjesëmarrjen, por gjithashtu favorizon operatorët që tashmë kanë këtë licencë, pavarësisht nga mungesa e një lidhjeje të qartë me nevojat e kontratës. Eksperti shqyrtues rekomandon që AK të heqë këtë kërkesë nga FDT ose ta bëjë atë opsionale, për të siguruar që operatorët që janë të aftë të përmbushin kërkesat kryesore të mos përjashtohen padrejtësisht. Nëse AK e konsideron këtë licencë të domosdoshme, ajo duhet të ofrojë një arsyetim të qartë dhe të dokumentuar, duke shpjeguar lidhjen e saj të drejtpërdrejtë me përmbushjen e objektivave të kontratës dhe duke siguruar që kërkesa është e justifikuar. Një qasje e tillë do të promovonte proporcionalitetin dhe transparencën dhe do të garantonte respektimin e parimeve të barazisë dhe konkurrencës, duke shmangur kufizimet e panevojshme për operatorët ekonomikë dhe duke

kontribuar në një proces të drejtë dhe gjithëpërfshirës të prokurimit publik.”

Konstatimi i trete (III): “Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i KosovaMed Healthcare SH.P.K. ngre çështje të rëndësishme për përputhshmërinë e veprimeve të AK me dispozitat e LPP-së dhe RrPP-së. Ndërsa ankuesi pretendon se kriteret janë përshtatur për një OJQ specifike, ky pretendim nuk mbështetet nga prova konkrete. Sipas ankuesit kriteret janë diskriminuese dhe krijojnë avantazh për një operator të caktuar, por nuk ka ofruar dokumente ose fakte që dëshmojnë se këto kritere janë krijuar enkas për të favorizuar një operator specifik. Pretendimi mbështetet në argumente të përgjithshme dhe mungon një lidhje e qartë midis kërkesave të vendosura dhe përfitimit të një operatori të caktuar. Sidoqoftë, kërkesat e vendosura nga AK konsiderohen kufizuese dhe disproporcionale, pasi ato dëmtojnë konkurrencën dhe përjashtojnë padrejtësisht operatorët ekonomikë që plotësojnë pjesën kryesore të kërkesave të kontratës. Vendosja e kriterëve që kufizojnë konkurrencën është në kundërshtim me parimet e përcaktuara në nenin 7 të LPP-së, i cili kërkon trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Gjithashtu, këto kritere shkelin nenin 25.7 të Rregullorës nr.002/2024, i cili përcakton që kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës, duke shmangur kufizimet e panevojshme për pjesëmarrjen në tender. Për më tepër, DT nuk është përgatitur në përputhje me nenin 27 të LPP-së dhe nenit 17.17 të Rregullores 002/2024, duke mos siguruar një nivel të përshtatshëm të konkurrencës dhe duke krijuar avantazh të padrejtë për disa operatorë ekonomik. Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga AK, pa një arsyetim të qartë dhe të bazuar ligjërish, përbën një shkelje të nenit 108/A të LPP-së, i cili kërkon që vendimet për refuzim të jenë transparente dhe të dokumentuara në mënyrë të qartë. Përpjekja e AK-së për të transferuar përgjegjësinë e vendosjes së kriterëve te njëria kërkuese është gjithashtu në kundërshtim me nenin 11.1/f të Rregullores, në të cilin thuhet se përcaktimi i kriterëve duhet të bëhet nga Zyrtari përgjegjës i prokurimit në bashkëpunim me udhëheqësit e njëjse kërkuese.”

Perfundim nga eksperti shqyrtues: “Eksperti shqyrtues rekomandon që ankesa e KosovaMed Healthcare SH.P.K. të konsiderohet pjesërisht e bazuar. Ankesa është e bazuar në lidhje me pretendimin se kriteret e vendosura nga AK janë jorelevante dhe disproporcionale, pasi ato kufizojnë konkurrencën dhe përjashtojnë padrejtësisht operatorët ekonomikë që përmbushin pjesën më të madhe të kërkesave të kontratës. Megjithatë, ankuesi nuk ka ofruar prova konkrete që tregojnë se këto kritere janë përshtatur posaçërisht për të favorizuar një OJQ specifike, siç pretendohet. Për këtë arsye, ankesa nuk mund të mbështetet plotësisht në këtë aspekt. Eksperti sqaron se ashtu siç potencohet në nenin 9.12 të Udhëzuesit se “është në diskrecionin e AK-së të përcaktojë kërkesat në FDT, në përputhje me nenin 52.4 të LPP-së, por ky diskrecion duhet të ushtrohet me kujdes dhe në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe barazisë”. Kriteret e përcaktuara nuk duhet të kenë efektin e kufizimit të padrejtë të konkurrencës apo të krijojnë avantazhe për një operator specifik, por duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Për më tepër, refuzimi i kërkesës për rishqyrtim është bërë pa një arsyetim të qartë dhe të bazuar ligjërish, duke shkelur nenin 108/A të LPP-së, i cili kërkon që vendimet për refuzim të jenë të arsyetuara dhe të komunikohen në mënyrë transparente. Mungesa e një përgjigjeje të dokumentuar nga AK ka dëmtuar besimin dhe transparencën e procesit të prokurimit.

Rekomandimet: 1. Eliminimi i kriterëve diskriminuesë dhe favorizuesë: AK duhet të sigurojë që kërkesat e vendosura janë proporcionale dhe relevante për objektin e kontratës. 2. Korrigjimi i Dosjes së Tenderit: AK duhet të përdorë formularin standard B54 për të rishikuar dhe përmirësuar Dosjen e Tenderit, në përputhje me nenin 27 të LPP-së dhe nenin 25.17 të RrPP-së nr.002/2024. 3. Shtyrja e afatit për dorëzimin e ofertave: Për të siguruar kushte të barabarta për operatorët ekonomikë, AK duhet të shtyjë afatin në përputhje me nenin 53.7 të LPP-së. 4. Ofrimi i përgjigjeve të qarta për kërkesat për rishqyrtim: AK duhet të garantojë që vendimet e saj janë të bazuara në dispozita ligjore dhe të komunikohen në mënyrë transparente, duke trajtuar çdo pretendim të ngritur nga operatorët ekonomikë. Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të përmirësojë ndjeshëm transparencën, drejtësinë dhe konkurrencën në procesin e prokurimit, duke siguruar një trajtim të barabartë për të gjitha palët e interesuara dhe duke shmangur kufizimet e panevojshme në konkurrencë.”

Argumentimi në raportin e ekspertës/teknike është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertës/shqyrtues/teknike mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “KosovaMed Healthcare SH.P.K.”, janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP-së lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime shëndetësore shtëpiake-paliative dhe shërbime sociale e rezidenciale për personat në nevojë në Komunën e Shtimës”- Kontratë

kornizë për 24 muaj” me numër të prokurimit 617-24-12907-2-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “KosovaMed Healthcare SH.P.K.”, aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Lidhur me pretendimin e pare ankimor të parashtruar nga OE ankues i cili pretendon se AK ka kërkuar licenca Nacionale PSH e mbështet pjesërisht përgjigjen e dhënë nga eksperti shqyrtues i cili e vlerëson se pretendimi i ankuesit është i bazuar, pasi kërkesa e AK-së për licenca "në nivel nacional" është disproporcionale dhe e njëjta nuk lidhet qartë me objektivin e kontratës, e cila ka fokus të kufizuar lokal në Komunën e Shtimes, andaj në mbështetje të kësaj PSH e obligon AK që gjatë përmirësimit të kërkesave të vendosura në DT të kërkojë vetëm licenca të leshuara nga Ministria perkatese për kryerjen e ketyre shërbimeve dhe jo të potencohet në nivel “nacional” ose “lokal” sepse konsiderohet se kriteri është diskriminues.

Lidhur me pretendimin e dytë ankimor të parashtruar nga OE ankues i cili pretendon se në mënyrë diskriminuese është vendosur në kërkesa në DT lidhur me licencat që OE ofertues të kenë licenca stomatologjike si dhe licence për ambulanca stomatologjike PSH ia fal besimin përgjigjes se dhënë nga eksperti duke konstatuar se nëse AK e qëllimin e për të kërkuar edhe këto shërbime atëherë AK me qëllim që të mos diskriminojë ndonjë OE të përmirësojë kërkesën e vendosur në DT dhe për këto shërbime të mundësojë që OE ofertues të ofertojnë me marrëveshje me ndonjë mjek në drejtim të profilit të stomatologjisë ose edhe marrëveshje me ndonjë ordinancë stomatologjike por jo të kërkojë licenca drejtpërdrejtë për OE ofertues pasi të njëjtit do të ofertojnë të kryejnë këto shërbime për të cilat është edhe qëllimi i kontratës.

Lidhur me pretendimin e tretë ankimor PSH mbështete përgjigjen e dhënë nga eksperti shqyrtues i cili konstaton se AK nuk ka zbatuar dispozitat ligjore nga neni 7 të LPP-së, duke qenë diskriminues në raport me operatorët ekonomikë, mirëpo OE ankues nuk ka ofruar dëshmi bindëse e që mund të rezultojnë se i janë përshtatur për një OJQ specifike.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbime shëndetësore shtëpiake-paliative dhe shërbime sociale e rezidenciale për personat në nevojë në Komunën e Shtimes”- Kontratë kornizë për 24 muaj” me numër të prokurimit 617-24-12907-2-1-1 që AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit duke kërkuar nga AK-ja që të bëjë përmirësimin e kërkesave të vendosura në DT sikurse përshkruhet në këtë vendim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - KOMUNA SHTIME
- OE - KosovaMed Healthcare SH.P.K.
- Arkivës së OSHP-së: